

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“Salesforce Consulting AL” Sh.p.k

Unë Enkeleda Hysa, e bija e Izetit datëlindjes 26.08.1986 lindur ne Pogradec dhe banuese ne Tirane, me numer personal I65826080E

Unë Ervin Hysa, i biri i Reshatit ,i datëlindjes 15.02.1987, Shtetas Amerikan me numer pasaporte: A41926136, banues ne 43885 Stony Lane, Sterling Heights, MI 48313, USA

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 15.01.2025 krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Salesforce Consulting AL” , me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1


Formohet shoqëria private e quajtur Salesforce Consulting AL Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërise tregtare private Salesforce Consulting AL . do të jetë :
Njesia administrative Nr 7, Rruga Astrit Balluku, Pallatet Gora, Kulla nr 3, Ap Nr 26



Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

IT Konsulence e specializuar në marrëdhënie menaxheriale me klientet (IT Consulting specializing in Customer Relationship Management CRM) dhe shërbime të tjera të telekomunikacionit

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private Salesforce Consulting AL do të jetë 100,000 Leke (Njëqind mijë) leke. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali përbëhet nga 2 kuota

Znj. Enkelelda Hysa zotëron 1 kuote me vlere 50,000 Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar
Z. Ervin Hysa zotëron 1 kuote me vlere 50,000 Leke qe perben 50% te kapitalit themeltar



Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Znj Enkeleda Hysa e cila është edhe përfaqësuesi ligjor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet , nga dat 15.01.2025 deri ne daten 14.01.2030

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë sipas kuotave, ,Znj. Enkeleda Hysa 50/100 dhe Z. Ervin Hysa 50/100

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.


NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13



Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14


Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare **Salesforce Consulting AL**

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues.



ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Salesforce Consulting AL

Enkeleda Hysa

Handwritten signature of Enkeleda Hysa in blue ink, with the name written in a cursive script.

Ervin Hysa

Handwritten signature of Ervin Hysa in blue ink, with the name written in a cursive script.Handwritten signature of Ervin Hysa in blue ink, with the name written in a cursive script.